




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dop. Dop. Dop.	2-D/DPK
Nr. Uta Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	01-3112/15
Data Datum Date	06.10.2015



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.10.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 02-2204/15, për z. Shkumbin Gashi, Nënkyetar i Komunës së Pejës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK - 03 -02 - 2204/15, për zyrtarin e lartë z. Shkumbin Gashi - Nënkyetar i Komunës së Pejës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Gashi është hetuar për konflikt interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat N.T.Sh. "DOZER-CAT".

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) fillimisht i ka dërguar shkresën zyrtare - njoftim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës zyrtari i lartë është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë.

Ai është njoftuar me kufizimet në ushtrimin e funksioneve menaxheriale, krahas ushtrimit të funksionit publik, si dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit.

z. Gashi ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të shmang konfliktin e interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, (DPKI 03-02-2751/15), të lëshuar nga ARBK, me të cilën vërtetohet se është larguar nga pozita menaxheriale në biznesin privat. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

